



Ka perfunduar ne barazim ndeshja mes Kukesit dhe Teutes. Ky takim spektakolar per emocionet dhe dyluftimet qe solli u luajt ne fushe asnjane ne Shkoder, per shkak te denimit qe ka marre skuadra e Kukesit per shkak te incidenteve me tifozet. Teuta e Maganit i ka shkuar me prane fitores pas disa rasteve per gol dhe nje shtylle te goditur por Kukesi ka patur fatin me vete. Ndeshja pergjate 90 minutave eshte luftuar shume dhe nuk kane munguar perplasjet mes lojtareve. Magani kishte hedhur ne fushe nje skuader te vendosur mire dhe ne fund ka marre nje pike qe i dergon ne vendin e pare ne tabelen e klasifikimit. Kukesi i Armando Cungut pasi mundi Skenderbeun nuk ja doli te merrte nje tjetër rezultat pozitiv edhe pse ishte nje ndeshje shtepie e zhvilluar ne Loro Borici. Pas ketij barazimi Teuta ka shkuar ne kuoten e 8 pikeve ndersa Kukesi ne kuoten e 4 pikeve.